



Republika Kosovo
Republika e Kosoves
Republic of Kosovo

Org. jed./Nj. org./Org. unit O.R
Br. s./Nr.f./No.p./ 02-124/ Br./Nr./No./ 2026
Datum/Data/Date 31.08.2026
Opština Ranilug - Komuna e Ranillugut

Opština Ranilug
Komuna e Ranillugut
Municipality of Ranilug



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika (d), nenit 17, pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 („Gazeta Zyrtare e RK-së“ nr. 28/2008), nenit 14, pikat 2, 5, 7, si dhe pikat 8.1, 8.2 dhe 8.3 të Rregullores (QRK) nr. 19/2024 për procedurën e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukative-arsimore dhe aftësuese (IEOAA-A) të arsimit parauniversitar, nenit 15, paragrafi 15.1 të Statutit të Komunës së Ranillugut nr. 02-154/2011, Kuvendi i Komunës së Ranillugut, në mbledhjen e tetë të rregullt të mbajtur më 31.08.2026, miratoi:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORËVE TË ÇERDHEVE TË FËMIJËVE, SHKOLLAVE FILLORE DHE TË MESME NË TERRITORIN E KOMUNËS SË RANILLUGUT

1.

Propozimi i paraqitur është shqyrtuar në mbledhjen e tetë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ranillugut, të mbajtur më 31.08.2026, ku është miratuar dhe është aprovuar me shumicë votash.

2.

Themelohet Komisioni për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve publike edukativo-arsimore dhe të arsimit parauniversitar në Komunën e Ranillugut, në përbërjen si vijon:

2.1. Nemanja Stojanović, sekretar i SHF “Trajko Perić”, kryetar i Komisionit.

2.2. Aleksandar Artonović, drejtor i SHF “Veljko Dugošević”, anëtar.

2.3. Përfaqësuesi i MASH-it, anëtar.

2.4. Një mësimdhënës, vëzhgues.

2.5. Një prind, vëzhgues.

3.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit nga pika 2 e këtij Vendimi përcaktohen me Rregulloren (QRK) nr. 19/2024 për procedurën e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukative-arsimore dhe aftësuese (IEOAA-A) të arsimit parauniversitar.

4.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Drejtoria për Arsim dhe Zyra e Kryetarit.

5.

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit të tij në Kuvendin e Komunës.

Data 31.08.2026

Ranillug



Anëtari më i vjetër i KK së Ranillugut

Nebojsha Tasiq